

RELACION TEKNIK

PER MBROJTJEN DHE SHPETIMIN NGA ZJARRI



PROJEKT-PREVENTIVA ZBATIMI PER RIKONSTRUKSIONIN E PAVIONIT TE TE SEMUREVE KRONIKE BURRA
DHE TE PAVIONIT TE TE SEMUREVE KRONIKE GRA
NE SPITALIN PSIKIATRIK " ALI MIHALI " VLORË

PERMBAJTJA E RELACIONIT TEKNIK MNZSH-SE

Ky Relacion Teknik i projektit "Dokumentacioni Grafik per Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpetimin" i objektit "STRKTURE 2KT – PAVIONI I TE SEMUREVE KRONIKE BURRA NE SPITALIN PSIKIATRIK " ALI MIHALI " VLORË "" permban:

- Relacionin e projektit te arkitektures, arkitektura urbane per MNZSH-ne;;
- Relacionin e projektit konstruktiv te MNZSH-se
- Relacionin e projektit mekanik te MNZSH-se;
- Relacionin e projektit elektrik te MNZSH-se;
- Relacionin e projektit hidrik te MNZSH-se;
- Relacioni për skemat e evakuimit

MBESHTETJA LIGJORE DHE NORMATIVE

Projekti per Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpetimin i objektit "STRKTURE 2KT – PAVIONI I TE SEMUREVE KRONIKE BURRA NE SPITALIN PSIKIATRIK " ALI MIHALI " VLORË "", eshte realizuar ne baze te standarteve dhe normave lokale si dhe ato te vendeve te Komunitetit Europian. Sistemi i mbrojtjes kunder zjarrit respekton te gjitha kerkesat e detyrueshme shteterore qe kane te bejne me normat / standartet qe jane ne fuqi aktualisht ne Shqiperi si dhe normat Europiane.

Ligjet, rregulloret, normat dhe standartet e perdorura ne kete projekt jane paraqitur ne vijim:

- Ligji nr. 152/2015 "Per sherbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpetimit";
- Rregullore "Mbi masat e mbrojtjes kunder zjarrit ne projektimin e ndertesave te cdo lloji "Vendim nr.162 date 19.4.1965, e ripunuar;
- Udhezim i Ministrimit te Puneve te Brendeshme nr.425 date 24.7.2015 "Per pranimin, administrimin e dokumentacionit teknik dhe grafik te projektit te mbrojtjes nga zjarri dhe per shpetimin dhe leshimin e akteve teknike";
- Ligjin 107/2014, date 31.07.2014 , " Per Planifikimindhe Zhvillimin e Territorit ", i ndryshuar,
- Vkm Nr. 408, datë 13.5.2015, " Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit ", i ndryshuar,
- EN 13501 Fire classifications of construction products and building elements (all parts)
- EN 2 Classification of fires
- EN 1838 Lighting applications – Emergency lighting
- EN 1366 Fire resistance tests for service installations
- EN 3-7: Portable fire extinguishers. Characteristics, performance requirements and tests.
- BS EN B2: Fire Safety – Buildings other than Dëell ringing houses – Volume 2

QELLIMI

Qëllimi i këtij relacioni është që të kryejë një analize të rrezikut nga zjarri në objekt dhe nëpërmjet saj të përcaktojë kriteret e projektimit dhe mbrojtjes aktive për të zvogëluar shkallën e dëmit të shkaktuar nga vetë zjarri

ANALIZE E TERRITORIT

GJENDJE EKZISTUESE

Zona spitalore ndodhet ne pjesen juglindore te qytetit te Vlores. Arteria kryesore rrugore e qytetit qe ben te mundur arrijten e kesaj zone eshte Rruga " Ibrahim Avdullai " me orientim te aksit te tij ne drejtimin jug-veri. Kjo zone eshte e vendosur ne lindje te aksit te kesaj rruge. Ne perendim kjo zone spitalore , ne gjithe gjatesine e saj kufizohet me kete rruge. Ne lindje , kjo zone kufizohet pjeserisht me aksin rrugor " Refit Jazo ". Ne pjesen veriore , jugore dhe pjeserisht lindore zona spitalore rrethohet me ndertime informale banimi dhe objekte sherbimi 1kt deri ne 3 kt.

Zona spitalore ka nje shtrirje ne plan ne drejtimin ju-veri. Ajo ka nje gjatesi mesatare rreth 156m ne drejtimin jug-veri dhe nje gjeresi mesatare ne drejtimin perendim-lindje rreth 85m. Siperfaqja e territorit te rrethuar eshte afersisht 10385.13m². Siperfaqja e gjurmes nga strukturat eshte S=2941.9m². Koeficienti i shfrytezimit te tokes eshte 0.283.

Siperfaqja e pergjithshme e ndertimit eshte 4918.78m². Intensiteti i ndertimit per zonen spitalore eshte 0.47. Siperfaqja e gjelberimit eshte 7729m². Koeficienti i shfrytezimit te tokes per gjelberim eshte 0.74. Siperfaqja e rrugeve dhe shesheve te sherbimit eshte 956m².

Spitali Psikiatrik " Ali Mihali " Vlorë, ndodhet ne lindje te rruges " Ibrahim Avdullaj ", Bashkia Vlore, ne koordinatat UTM Zone 34N : E 372614.59 dhe N 4478968.33. Objekti është ndërtuar në vitet 1924. Siperfaqja e pergjithshme e territorit e matur ne fakt (Brenda rrethimit ekzistues) eshte 10385.13m².

Zona spitalore sipas dhe planvendosjes me poshte eshte e perbere nga keto objekte sipas emerteses:

1. Korpusi kryesor , 3kt
2. Pavioni 4-5 , 2kt
3. Pavioni 1-2, 1kt
4. Pavioni 6-7, 1kt
5. Magazina, garazhe, 1kt
6. Ergoterapia , 1kt
7. Kabine elektrike



PLANVENDOSJE E OBJEKTEVE BRENDA ZONES SPITALORE

Objektet kryesore te zones spitalore jane me fasada kryesore te orientuara nga perendimi. Hyrja kryesore per ne keto objekte eshte e pozicionuar ne pjesen vperendimore te tyre, perjashtuar korpusit kryesor I cili e ka hyrjen nga lindja. Hyrja kryesore per ne zonen spitalore eshte ne pjesen perendimorete saj. Zona spitalore komunikon me territorin rrethues dhe rruget kryesore te qytetit me nje hyrje kryesore te pozicionuara ne perendim te saj. Objektet e zones spitalore jane nga 1kt deri ne 3kt. Objektet kane si mbulese çati me tjegulla marsejeze dhe taraca. Vetem objektet me emertimin pavioni 1-2 dhe pavioni 6-7

kane si mbulesa cati me tjegulla marsejeze. Te objektet e tjere jane me mbulesa tarace. Ne te gjitha siperfaqen e zones ekziston nje gjelberim i ulet , i mesem dhe i larte por ai eshte i zhvilluar ne menyre kaotike. Pare ne orthofoto zonen spitalore vihet re nevoja e nderhyrjes dhe sistemimit te te gjitha territorit . Kjo jo vetem ne aspektin formal por dhe funksional.

Ne pamje te pare del e nevojshme dhe ne menyre urgjente realizimi i nje hyrje te dyte kryesore dhe kjo jo vetem per arsye te rregullimit te levizjes, furnizimit etj, por dhe per rastet e emergjencave.

Realizimi me sukses i ketij projekti zbatimi eshte arritur duke bere nje analize te thelle te situates ne terren, te situates se sherbimit mjeksor ne kete zone spitalore dhe jo vetem .

Gjithashtu eshte pare e domosdoshme dhe berja e nje analize tekniko ekonomike lidhur me pavionet 1-2 dhe 6-7 .

ANALIZE E TERRITORIT PAS NDERHYRJES

Zona spitalore ka nje shtrirje ne plan ne drejtimin ju-veri. Ajo ka nje gjatesi mesatare rreth 156m ne drejtimin jug-veri dhe nje gjeresi mesatare ne drejtimin perendim-lindje rreth 85m. Siperfaqja e territorit te rrethuar eshte afersisht 10385.13m². Siperfaqja e objekteve qe prishen ne total eshte: 1544.8m². Siperfaqja e objekteve ekzistuese qe ngelen eshte 1397.1m² Siperfaqja e gjurmes nga struktura e re eshte S=623.665m². Siperfaqja e ndertimit pas ndertimit te struktures se re eshte 2020.76m². Siperfaqja e pergjithshme e objekteve qe ngelen plus siperfaqe objektit te propozuar eshte :

Siperfaqja e pergjithshme e objekteve ekzistuese qe ngelen eshte 4219.64m²

Siperfaqja e pergjithshme e objektit te ri 2kt eshte 1377.61m²

Koeficienti i shfrytezimit te tokes eshte 0.194.

Intensiteti i ndertimit per zonen spitalore eshte 0.54.

Siperfaqja e gjelberimit eshte 9455.13m². Koeficienti i shfrytezimit te tokes per gjelberim eshte 0.91.

Siperfaqja e rrugeve dhe shesheve te sherbimit eshte 930m².



Zjarr është djegia e pakontrolluar që zhvillohet, pa kufizime në kohë dhe hapësirë dhe që rezulton në nxehtësi(afsh), tym, gaz dhe drite.

Per te ndodhur një zjarr është e nevojshme prania e tre elementeve themelore, të cilat përbëjnë të ashtuquajturin "Trekëndëshi i zjarrit":

1. Materiali kombustibel (karburanti)
2. Materiali komburent (oksidues, oksigjeni i ajrit)
3. Ndezezi

Kur një nga tre elementet e trekëndëshit zjarrit mungon, djegia nuk bëhet ose në se është në zhvillim e sipër , për shuarjen e zjarrit mund të perdoren tre sisteme

1. Sistemi i lodhjes ose i shterjes - heqja ose ndarja e karburantit
2. Sistemi i Asfiksimit, ose një ulje përqindje e ajrit të djegies nën pragun minimal.
3. Sistemi i ftohjes, për të marrë një temperaturë më të ulët se temperatura e nevojshme për ushqimin e djegies.

Ne fakt sic dihet , djegia është një reaksion zinxhir, ose me sakte një reaksion në të cilin molekula fillestare (e karburantit dhe oksigjenit) transformohen në produktin përfundimtar nepermjet staveve të ndërmjetme , lidhur bashkë si hallkat e një zinxhiri.

Zjarret mund të ndahen në klasa, sipas llojit të karburantit (kombustibilit) sipas UNI EN 2. Ato ndahen në Klasa A, B, C, D, E, F.

Dinamika e zjarreve

Në evolucionin e një zjarri merret në konsideratë sjellja në funksion të kohës dhe temperaturës së gazeve djegies, thënë ndryshe kurba e zjarrit:

Individualizohen 4 zona themelore

- Ndezja - faza fillestare e zjarrit, kur avujt e materialit të djegshëm, si ato të ngurta ashtu dhe ato të lëngshme, fillojnë procesin e djegies dhe kjo djegie është lehtësisht e kontrollueshme.
- Përhapja - karakterizohet nga temperatura të ulëta dhe sasi të ulët të karburantit të përfshirë.
- Nxehtësia shfaq zjarrit dhe verëhet një rritje e lehtë e temperaturës e cila shoqërohet me emetimin e tymit.
- Zjarr i plote - të gjitha materialet marrin pjesë në djegie dhe temperatura arrin vlera të larta (rreth 1000 ° C) dhe djegia është e pakontrollueshme.
- Shuarja dhe ftohja - është faza përfundimtare e djegies e zaurimi (përfundimi i djegies) ose asfiksimi (fundi i djegies) që shoqërohet me ftohje e mëvonshme të zonës së prekur nga zjarri.

Produktet e djegshme

Produktet e djegies janë në thelb flaka, nxehtësia, tymi dhe gazrat e djegies. Flaka është një fenomen i shndritshëm ,tipik i djegies, i cili është edhe treguesi më i qartë. Fizikisht, drita e emetuar është për shkak të molekulave të produkteve të gaztë të djegies, tepër aktive, të cilat emetojnë energji të tepërt në formën e fotoneve në spektrin e dukshëm.

Disa materiale digjen pa shfaqur flake : në këto raste gjatësia e vales të fotoneve të emetuara nga gazi nuk është e dukshme, por vetëm në infra të kuqe Ngjyra e flakes është treguesi më i mirë i përbërjes kimike të një substance. nënshtruar spektroskopise, drita e flakes zbulon një seri e vijave spektrale ,karakteristike e molekulave dhe elementeve të përfshira në gaz. Ky fenomen ka qenë gjerësisht i studiuar dhe ka qenë prej kohësh pjesë e procedurave standarde të analizave kimike cilësore.

Tabela më poshtë lejon që nepermjet ngjyrës së flakës, të percaktohet temperatura e flakës.

Temperatura në °C në varesi të ngjyrës së flakes

| Ngjyra e flakes | Temperatura ne °C |
|------------------------------|-------------------|
| AMARANT (VISHNJE) E ZBEHTE | 480 |
| AMARANT (VISHNJE) | 525 |
| E KUQE GJAKU | 585 |
| E KUQE E ZENE | 635 |
| E KUQE E QESHUR | 675 |
| E KUQE E ZBEHTE | 740 |
| ROZE | 845 |
| PORTOKALLI | 900 |
| E VERDHE | 940 |
| E VERDHE E ZBEHTE | 995 |
| E BARDHE | 1080 |
| BOJEQIELLI | 1400 |

Efektet mbi njeriun te nje zjarri

| ENERGJIA NE KW/m2 | EFEKTI MBI NJERIUN |
|-------------------|---|
| 40 | 1 % PROBABILITET PER MBIJETESE |
| 26 | ZJARR I SHKAKTUAR NGA MATERIALE TE DJEGSHME |
| 19 | 50 % PROBABILITET PER MBIJETESE |
| 5 | DËMTIMI I PERSONAVE ME VESHJE MBROJTËSE EKSPOZUAR PËR NJË KOHË TË GJATË |
| 2 | DJEGIE E SHKALLES II |
| 1.8 | DJEGIE E SHKALLES I |
| 1.4 | KUFIRI SIGURISE PËR NJERËZ TË VESHUR POR EKSPOZUAR PËR PERIUDHE TË GJATE |

Efektet mbi materialet e ndertimit

| ENERGJIA NE KW/m2 | EFEKTI MBI MATERIALET E NDERTIMIT |
|-------------------|--|
| 60 | DEMTIM I STRUKTURAVE TE BETONIT |
| 40 | DEMTIM I KONSTRUKSIONEVE METALIKE |
| 33 | NDEZJE E DRURIT BRENDA 1 MINUTE |
| 12.6 | DEMTIM I TANKEVE (DEPOZITAVE) METALIKE |
| 11.7 | DEMTIM I KAVOVE ELEKTRIKE |

Ngjyra e tymit bazuar ne tipin e lendeve te djegshme

| NGJYRE E TYMIT | TIPI I LENDES SE DJEGSHME |
|----------------|--|
| I BARDHE | FOSFOR, KASHTE |
| E VERDHE/KAFE | NITROCELULOZA, BARUTI, ACID NITRIK, SULFUR, ACID SULFORIK |
| GRI/KAFE | LETER, DRU, STOF |
| KAFE | VAJ KUZHINE |
| KAFE/E ZEZE | VAJGURI , DILUEND PER BOJRA |
| E ZEZE | BENZINE, QYMYR, CATRAN, PLASTIKE, VAJGURI, VAJ LUBRIFIKANTE |
| VJOLLCE | JOD |

Gazrat me frekuent prodhuar nga zjarri

- Oksidi i karbonit (CO)
- Anidridi karbonik (CO2)
- Sulfurit hidrogjeni (H2S)
- Anidrit sulfurik (SO2)
- Amoniak (HN3)
- Acid cianidrik (HCN)

- Acid kloridrik (HCl)
- Peroksid azoti (NO₂)
- Aldeid akrilik (CH₂CHCHO):
- Fosgjen (COCl₂):

STRUKTURA SPITALORE

Struktura e zones spitalore Vlore eshte strukture Poliblok dhe Polispesilistik , me shtrirje horizontale ne plan dhe me nje vertikalitet qe shkon deri ne 3 kt.Kjo zone karakterizohet deri diku nga urbanizimi dhe mikpritja.

ANALIZE E TERRITORIT- Sipas Planit te Pergjithshem Vendor te Bashkise Vlore

Rregullorja Vendore e Planifikimit të Territorit të bashkisë Vlore-PPV

Bazuar ne Rregulloren e Planit te Pergjithshem Vendor te Bashkise Vlore, zona ne te cilen kerkohej te nderhyhet eshte percaktuar si zone UB-Urban; SH-Shendetesi; SH.1-Zone spitalore .

Kjo zone bazuar ne Harten e propozuar te perdorimit te tokes si dhe ne Rrjetin rrugor te propozuar kufizohet me :

- Ne perendim me aksin rrugor " Ibrahim Avdullai "
- Ne veri me - Njesine Strukturore VL.UB.6.1262
- Ne jug me - Njesine Strukturore VL.UB.4.559
- Ne lindje me - Njesine Strukturore QE.B.57

Pasaporta per Njesine Strukturore VL.UB.4.550 eshte si me poshte:

- Zona - VL.UB.4
- Njesia Strukturore VL.UB.4.550
- Siperfaqe 1.12 ha
- Sistemi – UB
- Kategoria baze e perdorimit te tokes – SH
- Nenkategorite e perdorimit – SH.1
- Perdorime te lejuara- SH
- Perdorime te ndaluara- A.S
- Tipologjia- IS
- Nderhyrja- Rigjenerim
- PDV- Jo
- Intensiteti – 1.6
- Ksht max. – 40
- Nr kateve – 10
- Lartesia max - 33m
- Kshr- 0
- Kshp- 0

ANALIZE E SHESHIT TE NDERTIMIT

Territori ku do te ndertohet objekti i ri eshte i sheshte dhe me forme te crregullt gjeometrike. Ai ka nje gjeresi mesatare 15.74m ne pjesen me te ngushte dhe 24.35m ne pjesen me te gjere te siperfaqes. Gjatesia mesatare e sheshit eshte 95m.



Struktura do te kete nje hyrje kryesore te kontrolluar dhe nje te dyte e cila me teper do te luaj rolin e vete ne rastet e emergjencave apo te sherbim-furnizimeve.

Siperfaqe e sheshit te krijuar pas prishjes se objekteve ekzistuese plus shtesat do te jete 2237.14m². Ky shesh i krijuar do te kete dy mundesi komunikimi me ambientin rrethues te zones spitalore. Mundesia e pare do te jete nepermjet nje shkallare te pozicionuar ne perendim te tij, I cili do te siguroje lidhjen e objektit te ri 2kt dhe territorit qe e rrethon ate me zonen spitalore dhe aksin rrugor " Ibrahim Abdullai ". Mundesia e dyte, sic dhe jepet ne planvendosjen e struktures, do te realizohet nepermjet ndertimit te nje nje rruge qe lidh zonen spitalore , ne lindje te saj , me aksin rrugor " Refit Jazo ".



PERSHKRIM I PROJEKTIT TE PROPOZUAR

Bazuar ne detyren e projektimit por dhe ne eksperiencen nderkombetare te zhvillimit te struktureve me funksion pavion i te semureve kronike psikiatrik burra dhe gra, grupi i projektimit ka realizuar:

Strukture te re 2kt me podrum, duke patur si pikenisje formen e objektit ekzistues te pavionit 6-7 ndertimi i te cilit daton vitin 1922. Krijimi i hapsirave funksionale te kerkuara nga detyra e projektimit si dhe standartet bashkekohore te trajtimit te kesaj kategorie te pacientit kerkon nderhyrjen ne ndertimin e objektit te ri. Kjo nderhyrje ka sjelle arritjen e hapsirave te nevojshme per realizimin e sherbimeve te kerkuara.

Ky objekt do te shnderrohet ne nje strukture me nje sherbim te cilesise se larte ne funksion te personelit dhe pacientit ne perputhje te plote me funksionin percaktuar ne detyren e projektimit .


Per me qarte kjo jepet dhe ne pamjet tredimensionale volumetrike te paraqitura me poshte:

Objekti 2kt - Pavioni per te semuret kronike burra, eshte pozicionuar ne sheshin e ndertimit duke u vendosur gati gati ne aksin simetrik te zones spitalore me drejtimin gjeografik lindje-perendim.

Objekti eshte konceptuar me 2kt dhe me nje kat podrum me siperfaqe m² . Orientimi i ketij objekti ne brinjen me te gjate do te jete jug-veri. Fasada kryesore e objektit do te jete ne pjesen perendimore.

KATI PODRUM

Ne pjesen juglindore te objektit eshte i pozicionuar kati podrum me nje siperfaqe m². Ky kat do te sherbeje si ambient teknik me stacionin e pompave , depozitat e ujit, etj. Hyrja per ne kete kat do te realizohet nepermjet shkallares se pozicionuar ne jug te struktures. Kati podrum do te zhvillohet ne kuoten -3.23. Ky kat do te kete ndricim dhe ajrim natyral te drejtperdrejte . Kjo gje do te realizohet nga dritaret e pozicionuara ne pjesen lindore. Dera e hyrjes per ne keto ambiente do te jete dera garazhi e seksionuar me hapje dhe mbyllje skorevole vertikale ne pjesen tavanore, e motorizuar + manual.



KATI PERDHE

Kati perdhe ashtu si dhe kati i pare eshte i zhvilluar ne forme U te permbysur me hyrjen kryesore te pozicionuar ne pjesen perendimore te struktures se propozuar 2kt. Arritja per ne hyrjen kryesore realizohet nepermjet nje shkallare dhe kolonade monumentale te pozicionuar ne pjesen perendimore te struktures.

Kompozimi i ketij kati nga pikepamja funksionale e organizative eshte menduar bazuar ne detyren e projektimit por dhe konsultimin me ekipin profesional te sherbimit.

Ne kete kat propozohen keto ambiente funksionale.

1. Zona A
2. Zona B
3. Zona C

Zona A

Ne kete hapsire funksionale eshte menduar te pozicionohen ambientet e zones se hollit, korridoreve, kafazit te shkalleve. Kjo zone eshte e pozicionuar ne pjesen qendrore, te majte te hyrjes kryesore (ne veri te struktures), qendrore dhe te djathte (ne jug te struktures). Ne kete zone zhvillohen keto hapsira funksionale:

- Hyrje kryesore
- Holli kryesor
- Korridoret e sherbimit
- Kafazi i shkalleve

Zona B


Ne kete hapsire funksionale eshte menduar te pozicionohen ambientet e zones se dites dhe ato te sherbimit. Kjo zone eshte e pozicionuar ne pjesen e majte te hyrjes kryesore (ne veri te struktures). Ne kete zone zhvillohen keto hapsira funksionale:

- | | | |
|-----|--------------------------------|---------------------|
| 1. | Dhome Kryeinfermier | 1 DHOME |
| 2. | Dhome mikrokirurgji/injeksione | 1 DHOME |
| 3. | Dhome Ergoterapi | 1 DHOME |
| 4. | Dhome Psikologu | 1 DHOME |
| 5. | Dhome Punonjes social | 1 DHOME |
| 6. | Dhome Mjeku | 1 DHOME |
| 7. | Salle Ndenjeje | 1 DHOME |
| 8. | Salle Ngrenieje | 1 DHOME |
| 9. | Blloku h/sanitar+dushet | 1 DUSHE+3 WC+TOILET |
| 10. | Dalje emergjence | 1 DHOME |

Zona C

Ne kete hapsire funksionale eshte menduar te pozicionohen ambientet e zones se pacientit. Kjo zone eshte e pozicionuar ne pjesen e djathte te hyrjes kryesore (ne jug te struktures). Ne kete zone zhvillohen keto hapsira funksionale:

- | | | |
|----|-------------------------|---------------------|
| 1. | Dhoma pacienti | 9 DHOME |
| 2. | Blloku h/sanitar+dushet | 1 DUSHE+3 WC+TOILET |



KATI I PARE

Kati i pare eshte i zhvilluar ne forme U te permbysur, njesoj si kati perdhe. Arritja per ne hyrjen kryesore realizohet nepermjet nje kafazit te shkalleve te pozicionuar ne pjesen qendrore te struktures.

Kompozimi i ketij kati nga pikepamja funksionale e organizative eshte menduar bazuar ne detyren e projektimit por dhe konsultimitn me ekipin profesional te sherbimit.

Ne kete kat propozohen keto ambiente funksionale.

1. Zona A
2. Zona B
3. Zona C

Zona A

Ne kete hapsire funksionale eshte menduar te pozicionohen ambientet e zones se hollit, korridoreve, kafazit te shkalleve. Kjo zone eshte e pozicionuar ne pjesen qendrore, te majte te hyrjes kryesore (ne veri te struktures), qendrore dhe te djathte (ne jug te struktures). Ne kete zone zhvillohen keto hapsira funksionale:

- Korridoret e sherbimit
- Kafazi i shkalleve

Zona B

Ne kete hapsire funksionale eshte menduar te pozicionohen ambientet e zones se sherbimit. Kjo zone eshte e pozicionuar ne pjesen perendimore te struktures dhe ne qender te saj.

Ne kete zone zhvillohen keto hapsira funksionale:

- | | | |
|----|--------------------------------|---------------------|
| 1. | Dhome Infermier | 1 DHOME |
| 2. | Dhome Sherbimi dhe mbikqyrjeje | 1 DHOME |
| 3. | Dhome e rrobave | 1 DHOME |
| 4. | Blloku h/sanitar+dushet | 1 DUSHE+3 WC+TOILET |
| 5. | Dalje emergjence | 1 DHOME |


Zona C

Ne kete hapsire funksionale eshte menduar te pozicionohen ambientet e zones se pacientit. Kjo zone eshte e pozicionuar ne pjesen e djathte te hyrjes kryesore (ne jug te struktures). Ne kete zone zhvillohen keto hapsira funksionale:

1. Dhoma pacienti 20 DHOMA
2. Blloku h/sanitar+duset 1 DUSHE+3 WC+TOILET

Kafazi i shkalleve vazhdon me daljen ne soleten e mbuleses. Dalja ne kete kat nencati eshte e kontrolluar nga stafi i sherbimit. Mbi soleten e mbuleses zhvillohet catia e cila do te jete me structure metalike.

Dhomat per personelin e sherbimit do te jene te gjitha me lavamane ndersa dhoma e mjekut dhe dhoma e punonjesit social do te jene me wc+toilet.



Te gjithë dhomat per paciente ne katin perdhe do te jene me dy shtreter. Ne katin e pare 8 dhoma pacienti do te jene me tre shteter. Ne total do te jene 16 dhoma me wc+toilet. Ne katin e pare do te jene 2 dhoma me nje shtrat dhe wc+yoilet me vete. Numri pergjithshem i dhomave per paciente do te jete 21 dhoma pacienti ne katin e pare dhe 8 dhoma pacienti ne katin perdhe.

Numri i pergjithshem i pacienteve qe parashikohet te akomodohen eshte 62 paciente. Te gjithë dhomat e pacienteve do te jene me ndricim dhe ajrim te drejtperdrejte.

Per efekt sigurie dritaret do te jene me xham antivandal dhe me hapje vetem sopralue ne kendin 35° ne vertikal. Dritaret dhe dyert do te jene me zjarrdurueshmeri REI90.

Materiali i dritareve do te jete PVC i ngurte, me spesor 9cm, me 5 dhoma, me perforcues profili prej çeliku , termoizoluese dhe zeizoluese me zeizolim 45db, me xham antivandal, me xham termik-ai i jashtem, me dopioxham, me distance nga xhami i jashtem tek ai i brendeshem jo me te vogel se 1.5cm,me zjarrdurueshmeri T90, me zham transparent, me rrjete mizash , me grille kunder diellit me tambur, me rreshqitje vertikale

Permbajtja do te jete: depertueshmeri te ujit dhe ajrit BAG C sipas normes DIN 18055 qe do te thote klasi 3 per pershkueshmeri sipas DIN EN 12207 dhe klasi 9A per bllokimin e ajrit dhe ujit sipas DIN EN 12208.

Izolimi akustik (spesor te xhamit 5mm) $R_{wp}= 45db$. Izolimi termik me vlerat U_w sipas EN 10077. E shoqeruar me çertifikaten e prodhuesit me vule te njome sipas standarteve te KE-se per zonat spitalore.

Dyert e te gjithë dhomave do te behen nga brenda -jashte. Dyert e brendeshme do te jene druri, me nje kanate, me panel te jashtem dhe te brendeshem druri, me kornize inox, me hapje nga jashte, me vetmbyllje, hermetike, dopio guarnicion dyshemeje, adoptim lartesisë -20mm, brave doreze U, cilesia I, sipas standartit te K.Europian per zonat spitalore, e shoqeruar me çertifikate prodhimi te KE. Dyert do te jene me T-90 me zjarrdurueshmeri $820^{\circ}C$, zeizolim 38-40db. kolor sipas pamjes ose sipas kerkeses se investitorit

Koridoret e brendeshme do te jene edhe me ndricim dhe ajrim te drejperdrejte . Komunikimi ndermjet kateve dhe ambientin e jashtem do te realizohet nga kafazi shkalleve por dhe nga shkalla e emergjences ne rastet e renies se zjarrit apo te fatkeqesive natyrore. Lartesia e kateve dysheme-dysheme do te jete 3.61m.

Projekti i mbrojtjes kundër zjarrit është projektuar në përputhje me strukturat arkitektonike dhe konstruktive të godinës, dhe përveç kesaj merr për bazë dhe dy nga kriteret projektuese të mbrojtjes kunder zjarrit, që janë Mbrojtja pasive dhe Mbrojtja Aktive

Mbrojtja pasive :

Meqenëse kemi të bëjme me një objekte te ri , zgjidhja arkitektonike dhe konstruktive është realizuar në përputhje me normativat që janë në fuqi për këto tipe objektesh , per masat e mbrojtjes pasive kunder zjarrit .

Masat pasive përbëjnë tërësinë e masave arkitektonike dhe konstruktive duke zgjidhur dhe përcaktuar drejt rrugët e shpëtimit në korridore, shkallë, daljet e emergjences, shkallë të brendshme të mbrojtura, si për personelin dhe për të sëmurët, evakuimin e të sëmurëve me shtretër, sigurimin e kompartimenteve të mbrojtura nga zjarri dhe tymrat nëpërmjet strukturave ndërtimore si mure, tavane, dysheme, dyer etj. me rezistencë dhe qëndrueshmëri ndaj zjarrit (REI), sipas normave etj. Rrugët e evakumit dhe shpëtimit janë të plotësuara me sinjalistikën përkatëse sipas normave

MASAT MBROJTESE NGA ANA ARKITEKTONIKE .

“ STRUKTURA 2KT – PAVIONI I TE SEMUREVE KRONIKE BURRA NE SPITALIN PSIKIATRIK “ ALI MIHALI “ VLORË “, eshte nje objekt i ri 2kt me $85.75m^2$ kat podrum-nentoke.Ndertimi i kesaj structure te re shoqerohet me ndertimin e nje infrastructure te re. Kjo do te thote qe rrugët e kalimit të automjeteve zjarrfikëse janë të asfaltuara dhe të përshtatëshme për kalimin e tyre për aritjen në vend ngjarje (gje qe nuk mund te realizohej me gjendjen ekzistuese).

Kerkesa te vecanta per godinën dhe lidhjen me objektet per rreth. Godinat e mesiperme gjendet ne lindje te zones spitalore dhe arrihej deri me tani vetem nepermjet nje shkallare (pra, ishte e paarritshme nga automjetet). Ajo ndodhej ne nje distance rreth 83m nga rruga kryesore " Ibrahim Avdullai " me orientim te aksit te tij ne drejtimin jug- veri . Mjete zjarrfikese , deri me sot afroheshin ne piken me te afert , ne nje distance jo me te vogel se 30m.

Me ndertimin e kesaj structure te re 2kt , do te realizohet edhe rruga lidhese e sherbimit me aksin rrugor “ Refit Jazo “ e cila lejon lëvizjen e automjeteve. Te gjitha objektet qe kufizohen me objektin ne fjale nuk rrezikohen nga zjarri dhe kjo jo vetëm për shkak se gjenden ne distance të konsiderueshme nga njëra – tjetra por edhe për shkak te materialeve që janë perdorur në godinën e re si dhe të sherbimeve qe kryen ne mjediset e saj , te cilat nuk rrezikojnë .

Godina sipas pozicionit ku do te ndertohet do të respektojë distancat e sigurisë nga objektet e tjera përreth saj . Këto distance diktohen nga shkalla e qëndrueshmërisë ndaj zjarrit që do të të ketë ndërtesa dhe që janë të përcaktuara në normat e mbrojtjes nga zjarri. Rreth saj duhet të ketë hapsira të lira , të cilat lejojnë levizjen

e lirshëm , afrimin dhe veprimin pa pengesa të automjeteve dhe pajisjeve zjarrfikëse e të shpëtimit në rast situatë zjarri apo situatë tjetër emergjence .

Disa nga kushtet që janë respektuar

- Në katet e godinës apo në periferi të saj nuk do të ketë veprimtari apo depo me materiale ose lëndë lehtësisht të djegshme apo shpërthyesë..
- Do të ketë rrugë kalimi për automjetet dhe pajisjet zjarrfikëse për dhe nga kjo ndërtesë.
- Nuk duhet të ketë rrugë qorre
- Në rast zjarri automjetet dhe pajisjet zjarrfikëse e të shpëtimit do të afrohen dhe veprojnë të paktën nga dy anë të ndërtesës.
- Stacioni zjarrfikës më i afërt duhet të vijë në ndihmë jo më pak se 30 min.

MASAT MBROJTESE NGA ANA KONSTRUKTIVE

Pjesa konstruktive e objektit duhet të plotësojë normat e mbrojtjes nga Zjarri mbi Qëndrueshmërinë ndaj zjarrit të godinës si dhe sipërfaqen faktike dhe atë të kërkuar.

“ STRUKTURA 2KT – PAVIONI I TE SEMUREVE KRONIKE BURRA NE SPITALIN PSIKIATRIK “ ALI MIHALI “ VLORË “, është një objekt i ri 2kt me 85.75m² kat podrum-nentoke.

Ambjentet kryesore janë amjentet e pavionit spitalor me ambiente, dhoma gjumi (dhoma pacienti), dhoma mjeku, psikologu, punonjes social, Kryeinfermier, infermier etj , dhoma dite, tualete , dhoma dite dhe dhoma ngrënie etj .

Duke patur parasysh kategorine bejme një percaktim të mjedisëve të objektit.

Sasia e materialeve të djegshme brenda godinës ben që zjarret eventuale ne të klasifikohen të moderuara dhe djegie të ngadalte. Ndertesat sipas shkallës së qendrueshmërisë së tyre ndahen në pesë shkallë qendrueshmërie. Mure rrethuse prej tulle 25 cm , ku muret mbajtëse dhe muret e kafazit të shkallëve 4 orë të pa djegshme . Mure ndaresë prej tulle 12 cm .1 orë të pa djegshme soletat ndarëse midis kateve 1.5 , kollona , trarë . Tarraca 1.5 orë të pa djegshme , pavarishtë elementëve të mësipërm në godinë ka dhe shumë mobilje me dru , gjithsesi kjo nuk ul qëndrueshmërinë e objektit karshi zjarrit.

Kjo godine është ndertuar me elemente konstruktive që plotësojnë kushtet e vendosura nga normat e percaktuara në “Rregulloren mbi masat mbrojtëse kundër zjarrit në projektimin e ndërtesave të cdo lloji”., Në rastin tonë shkalla e qëndrueshmërisë e lejuar nga norma do të jetë shkalla e I –re , që është dhe shkalla e vetme e qëndrueshmërisë e lejuar nga normat .

Mbrojtja aktive :

Masat aktive

Masat aktive përbëjnë qëllimin e projekteve mekanike dhe konsiston në ndërtimin e sistemeve të mbrojtjes dhe shuarjes së zjarrit me qëllim mbrojtjen e personelit si dhe mbrojtjen e strukturave dhe aparaturave mjekësore dhe vetë godinës. Për këtë qëllim janë projektuar sistemet e shuarjes së zjarrit me ujë nëpërmjet sistemeve me hidrantë, me sistemet e shuarjes me gaz ose pluhur me pajisje dhe bombula portative në përputhje me kategoritë e zjarrit si dhe masa të tjera që kompletojnë impiantet e tjera elektromekanike, të cilat shërbejnë për parandalimin e përhapjes së zjarrit dhe të tymrave si dhe evakuimin e këtyre të fundit.

Kështu në projektet mekanike janë parashikuar masa specifike si vendosja e damperave të zjarrit dhe të tymit në kanalet e ajrit të kondicionimit në kalimet vertikale dhe horizontale të tyre etj. Impianti i mbrojtjes kundër zjarrit është realizuar në bazë të: dimensionimit të cdo sistemi, specifikimeve dhe cilësisë së materialeve të percaktuara në përputhje me standartet dhe normat lokale, si dhe normat italiane CNVVF/CPAI UNI 9485 etj dhe specifikisht në “Prevenzione Incendi Ospedali” D.M 18 Settembre 2002.

Objekti klasifikohet në shkallën e I të qendrueshmërisë.

Kushtet e mbrojtjes nga zjarri ne ndertese duhet te krahasohen me normat e kerkuara, ne rastin tone ato jane te plotësuara pasi :

- Grupi faktik i djegshmerise i strukturave te ndertimit dhe i vete ndertesave jane te barabarte me ato te pranuar ne norma. Relacion Teknik – Dokumentacioni Grafik per Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpetimin
- Kufiri minimal faktik i qendrueshmërisë ndaj zjarrit i strukturave te ndertimit eshte i barabarte me kufirin minimal te qendrueshmërisë pranuar nga norma.
- Shkalla faktike e qendrueshmërisë ndaj zjarrit e ndertesave eshte i barabarte me shkallen e qendrueshmërisë pranuar nga norma

Ne teresi, duke marre ne konsiderate edhe karakteristikat e struktures si dhe destinacionin e tyre, jane perdorur substanca shuarese si me poshte :

- nje rrjet hidrantesh te jashtem ne te gjitha territorin perreth struktures
- sistem i mbrojtjes nga zjarri me uje, me hidrante te brendshem per te gjithë godinën;
- shuares portabel në te gjitha pozicionet e treguara ne projekt.
- fikesit portabel te zjarrit:

Faktoret percaktues qe duhen marre ne konsiderate gjate projektimit te mbrojtjes aktive nga zjarri kane qene:

- Natyra dhe permasa e zjarrit dhe madhesia e zones qe do te mbrohet
- Mundesia e perhapjes me shpejtesi e zjarrit;
- Kerkesat dhe normat sipas UNI 10779 si dhe ato qe jane ne fuqi ne Shqiperi

Ne projekt jane percaktuar me saktësi edhe zonat qe kane lidhje me klasat e zjarrit si dhe vendet ku jane vendosur fikesit portabel te zjarrit.

Fikesit e zjarrit portabel me pluhur EN3 do te jene te klases 34A 233BC me karakteristika si me poshte:

Shuaresit e zjarrit portabel do te mirembahen dhe testohen te pakten ne cdo vit nga autoritete te licensuara per kete qellim.

Ne ambjentet e kabines elektrike do te vendosen fikes zjarri me CO2. Karakteristikat e tyre do te jene si me poshte: Fiksitet me CO2 do te mirembahen dhe testohen cdo 6 muaj nga autoritete te licensuara per kete qellim.

Struktura eshte projektuar te ndertohet sipas pershkrimeve te bera me siper. Rezistenca ndaj zjarrit e struktures dhe e sistemeve te ndarjeve sipas lartësisë duhet te garantoje respektivisht kerkesat e R, REI si me poshte:

- Kate te ndermjetme R/REI 60-90,
- Ndertësat ne lartësi antizjarr deri ne 24m, R/REI 901

| TIPI I NDERTESES | LARTESIA ANTIZJARR E NDERTESES | SIPERFAQA MAKSMIALE E AMBIENTEVE NE (m ²) | SIPERFAQA MAKSMIALE (m ²) E KATIT QE I PERKON NJE SHKALLE NE NDERTESE | TIPI I KAFAZIT TE SHKALLEVE DHE NJE KAFAZ PER ASHENSOR | KARAKTERISTIKAT REI TE KAFAZIT TE SHKALLEVE DHE ASHENSORIT, FILTRIT, TE DYERVE, TE MENTEVE NENDARJEVE NE KATE |
|---------------------|--------------------------------------|---|---|---|--|
| a | Mbi 12-24 m | 8000 | 500 | ASNJE PERCAKTIM | 60** |
| | | | 500 | TE PAKTEN TE MBROJTURA NQS NUK PERMBUSHEN KRITERET E PIKES 7.2. | 60 |
| | | | 550 | TE PAKTEN TE PROVES SE TYMIT TE BRENDESEHEM | 60 |
| | | | 600 | E PROVES SE TYMIT | 60 |

Klasa e qendrueshmerise ndaj zjarrit percaktohet si me poshte

| Klasa e qendrueshmerise ndaj zjarrit | Largesia maksimale e lejuar deri ne dalje ne m | |
|---|---|---|
| | Nga ambientet e banimit qe gjenden midis kafazit te shkalleve ose midis daljeve te jashtme | Nga ambientet e banimit qe dalin ne korridor te verbet |
| Klasa 0 : Struktura te padjegeshme | 40 | 25 |
| Klasa 1: Struktura te padjegeshme | 30 | 20 |
| Klasa 1: Struktura te djegeshme | 25 | 15 |
| Klasa 1,IM dhe te Klases 2 (sipas pikes 5) | 20 | 10 |

Ne projekt eshte parashikuar gjithashtu ndertimi i sistemit te mbrojtjes kunder zjarrit. Per kete parashikohet vendosja e dy grupe rezervuaresh me nga 6 depozita 4000l . Keto tre grupe rezervuaresh do te vendosen ne ambientet e katit podrum , brenda ambienteve ted homes teknike.

Ne dalje do te vendoset dy grupe me tre pompa uji me vakum dhe prej ketu do te furnizohen te gjitha hidrantet e parashikuara ne projekt. Sistemi i hidranteve do te kete edhe nje lidhje direkte me sistemin e ujesjellesit te rrjetit kryesor te zones. Hidrantet do te vendosen sic dhe eshte parashikuar ne projekt ne te gjitha perimetrin e e jashtem te struktures si dhe ne ne dy akse vertikale ne menyre qe te mbulohet siperfaqe e cdo kati. Te gjitha lidhjet, zgjatimet apo bashkimet e linjave te furnizimit do te behen me teknologjine qe percakton prodhuesi i tyre.

Komunikimi ndermjet shkalleve , ambienteve te vecanta te ndertesese , behet sipas tabelës se meposhtme:

| Tipi ndërtesës | Mënyra e komunikimit |
|----------------|---|
| a | Direkt |
| b | Përmes kalimeve me ndarje me rezistencë ndaj zjarrit REI 60 dhe rezistencë ndaj zjarrit të dyerve RE 60 |
| c | Përmes filtrit të provës së tymit, me rezistencë të ndarjeve ndaj zjarrit REI 60 dhe rezistencë të dyerve RE 60 |
| d, e | Hyrje direkte vetëm nëpërmjet hapësirave të jashtme |

Objekti që kërkohej të ndërtohej sipas rregullores së projektimit Neni 2, klasifikohet me materiale të padjeggshme si e shkallës së parë të qëndrueshmërisë ndaj zjarrit

| Nr. | Emertimi i strukturave | Kufiri qëndrueshmërisë ndaj zjarrit ore | Grupi i djeggshmërisë |
|-----|-------------------------------|---|----------------------------|
| 1 | Muret ndares me tulla me bira | 2.5 , 5.5 | Te padjeggshem |
| 2 | Kolonat b/arme | 2.5-4.5-6.5 | Te padjeggshme |
| 3 | Trare b/arme | 4.5 | Te padjeggshme |
| 4 | Solete monolite | 2.2 | Te padjeggshme |
| 5 | R (jashtë objektit) | 80 min | Te padjeggshme |
| 6 | REI (brenda objektit) | 60 min | Veshtiresisht te djeggshem |
| 7 | REI (dyert e dhomave) | 30 min | Te djeggshem |
| 8 | Cati druri | 20 min | E djeggshme |
| 9 | Mbulesë metalike | Mbi 5 ore | Te padjeggshme |

Skema e vendosjes së mjeteve zjarrfikëse dhe distancat e rrugeve të kalimit

Në planvendosjen e projektit " mbrojtja nga zjarri dhe shpëtimi " jepet qartë skema e levizjes së mjeteve zjarrfikëse si dhe pikat e grumbullimit. Në këtë objekt do të përdoret sistemi i kombinuar i MZSH-së, duke përfshirë sistemin hidraulik me fikse zjarri dore dhe të levizshme si dhe me mjete rrethore si fuci me rere, etj

Kritere të përgjithshme projektuese

Impianti i mbrojtjes nga zjarri është konceptuar që të ndërtohet në përputhje me kërkesat dhe normat specifike për përdorimin e teknikave dhe pajisjeve shuarëse që do të aplikohen mbi bazë të specifikave dhe klasave të zjarreve të mundshme në objekt.

Në analizë të zjarreve të mundshme rezultojnë se sistemi i shuarjes me ujë nëpërmjet hidrantëve zënë pjesën më të madhe në sistemin e mbrojtjes kundër zjarrit, por gjithashtu e shoqëruar me sistemin e mbrojtjes me pajisje portative me lëndë shuarëse të gaztë, pluhur etj mbi bazë të klasave të zjarrit të cilat nuk mund të shuhen me ujë.

Për sistemin e shuarjes me ujë me hidrantë, efikasiteti i sistemit të mbrojtjes kundër zjarrit varet në një shkallë të lartë nga mjaftueshmëria e kapacitetit të ujit dhe presionit të tij, të cilët duhet të jenë të mjaftueshëm për të mbrojtur sipërfaqet specifike mbi bazë të sasisë së nevojshme të ujit, kohës së veprimit etj. Ndërsa për sistemin e shuarjes me mjete portative efikasiteti i tyre konsiston në vatra zjarri të lokalizuara.

Faktorët përcaktues që janë marrë në konsideratë gjatë projektimit janë :

- Natyra dhe përmasa e zjarrit;

- Madhësia e zonës që do të mbrohet;
- Mundësia e përhapjes me shpejtësi e zjarrit;
- Kërkesat dhe normat sipas CNVVF/CPAI UNI 9485 si dhe ato që janë në fuqi në Shqipëri.

Për të siguruar funksionet dhe autonominë e sipërpërmendur impianti aktiv i mbrojtjes kundër zjarrit është i përbërë nga :

- a) centrali teknik i përbërë nga rezerva ujore dhe grupi i presurizimit,
- b) rrjeti i shpërndarjes dhe hidrantët,
- c) pajisjet shuarëse (fikse dhe portative),
- d) pajisjet e kontrollit të zjarrit dhe mospërhapjes së tymit.

Sistemi i shuarjes me ujë – me hidrantë

Sistemi i shuarjes me ujë është sistemi kryesor i impiantit të shuarjes nga zjarri i përdorur në objektin e spitalit. Kjo zgjedhje është në përputhje të plotë me vetitë shuarës të ujit për zjarre te klasës A .

Sistemi i shuarjes me ujë është i përbërë nga centrali teknik dhe rrjeti i shpërndarjes. Centrali teknik përbërëhet nga:

- rezerva ujore
- grupi i presurizimit,

Rrjeti i shpërndarjes përbëhet nga :

- rrjeti i shpërndarjes dhe kollonat

Pajisjet fikse përbehen nga:

- hidrantët,
- lidhja me autopompen

Sistemi i shuarjes me pluhur, gaz - pajisjet portative

- pajisjet shuarëse (fikse dhe portative),

Sasia e ujit të depozituar për mbrojtjen kundër zjarrit është përcaktuar duke marrë në konsideratë llogaritjet e konsumit të ujit nga numri i njëkohshëm i hidrantëve në punë në përputhje me numrin e kollonave të rrjetit shpërndarës, numrit të hidrantëve njëkohësisht në punë për cdo kollonë pra, nga numri total i hidrantëve njëkohësisht në punë.

Konsumi i ujit të çdo hidranti UNI 45 është 120 l/min dhe për të gjithë hidrantët njëkohësisht në punë parashikohet prurja që duhet të sigurojë grupi i presurizimit, ndërsa koha në të cilën duhet të garantohej kjo prurje për funksionimin e të gjithë hidrantëve është parashikuar 60 min.

Nëpërmjet këtyre dy parametrave bazë përcaktohet Sasia e rezervës ujore për mirëfunksionimin e sistemit të mbrojtjes nga zjarri me hidrantë.

Rezerva ujore mbahet në depozitat të vendosura në katin podrum së bashku me sasinë e ujit që nevojitet për qëllime sanitare, (ujë të ftohtë/të ngrohtë sanitar) duke përbërë kështu rezervën totale të ujit për nevojat e spitalit.

Depozitat e ujit do të kompozohen si më poshtë:

- Tubacionet e furnizimit me ujë, në të cilat do të vendosen valvola ndërprerëse që lidhen me galexhantët mekanik dhe elektrik që kontrollojnë nivelin e mbushjes;
- Tubacionet e shpërndarjes për impiantet, impianti i furnizimit me ujë sanitar, impianti i furnizimit me ujë të sistemit të mbrojtjes kundër zjarrit për hidrantët etj.. Në këto tuba do të instalohen valvola ndërprerëse me të gjithë aksesoret që kërkojnë centralët e pompave përkatëse;

- Tubi i shkarkimit (troppo pieno);
- Tubi i boshatisje që do të instalohen në pjesën e poshtme të rezervuarit. Ai duhet të jetë I pajisur me një valvul kontrolli;
- Tregues niveli në çdo furnizim për secilin rezervuar.

Grupi i presurizimit

Grupi i presurizimit është kompozuar në përputhje me kërkesat e projektit për të siguruar prurjen e nevojshme për furnizimin e të gjithë hidrantëve njëkohësisht në punë. Pompa është me parametra dhe karakteristika teknike e destinuar për rrjetin e hidrantëve. Pompa është e kompozuar nga elektropompa kryesore, e ushqyer si nga rrjeti normal elektrik dhe nga rrjeti i emergjencës (motogeneratori); nga pompa jockey (prove). Grupi i presurizimit i pajisur me panel kontrolli i cili komandon secilën pompë dhe pajisjet e tyre komandojnë në mënyrë të përcaktuar, nisjen, ndalimin e pompës duke realizuar njëkohësisht monitorimin dhe sinjalizimet e nevojshëm duke përcaktuar kështu statusin dhe kushtet e stacionit të pompimit.

Parametrat teknik të grupit të presurizimit llogaritur mbi bazë të prurjes së kërkuar për çdo hydrant të barabartë me 120 l/min, presionit në dalje në hidrantin në pozicionin hidraulik më të disfavourshëm të rrjetit të barabartë me 2 bar dhe humbjeve të rrjetit mbi bazë të formulës Hazen –Williams.

Pompa e mësipërme është zgjedhur mbi bazë të produkteve të çertifikuara të normave europiane dhe standartit EN 12845.

Rrjeti shpërndarës

Rrjeti i shpërndarjes është i ndërtuar me tuba dhe rekorderi të cilat respektojnë normat dhe kushtet teknike për impiantin e mbrojtjen kundër zjarrit. Rrjeti i shpërndarjes është furnizuar nga një linjë kryesore që vjen nga grupi i presurizimit në godinën teknike, shpërndahet vertikalisht në kollonat e hidranteve . Në godinë do të ngrihen kollonat që do të furnizojnë me ujë hidrantët të pozicionuar nëpër kate, në pozicione të përcaktuara për të mbuluar të gjithë sipërfaqen nga zjarri. Gjatë projektit është marrë parasysh që rrjeti i tubacioneve të ketë minimumin e numrit të përkuljeve dhe të kthesave të detyrueshme. Gjithashtu janë marrë parasysh zgjidhjet konstruktive të godinës. Tubat janë të pozicionuar dhe të siguruar për të minimizuar dëmtimet dhe vibrimet. Për shkak të lartësisë së godines janë marrë parasysh vendosja/ose jo e reduktorëve të presionit për të siguruar presionin e nevojshëm për çdo hydrant.

Linjat e rrjetit të shpërndarjes janë ndërtuar me tub çeliku të zi pa tegel me bashkim me saldim, me rakorderi (kurba, tee,) gjithashtu me bashkim me saldim, të trajtuar në sipërfaqe me pastrimin e ndryshkut dhe vajrave, të lyera me bojë antindryshk dhe bojë të kuqe RAL 3000 sipas normave. Fiksimi i tyre bëhet me fasheta sipas normave në distanca të përcaktuara, në kalimet horizontale çdo 10D, në kalimet vertikale çdo 15D.

Hidrانتët

Impiantet të palëvizëshme të shuarjes së zjarrit janë :

- Hidrante në brendësi të godinës
- Lidhjet me autopompën

Hidrانتët e zjarrit të tipit kasetë me ujë janë përzgjedhur si pajisje fikëse në sistemin e shuarjes së zjarrit për klasën A të zjarrit. Ata janë llogaritur të kenë në dispozicion të tërë sasinë e ujit të nevojshëm në rastin e shfaqjes së zjarrit. Kjo është bërë e mundur gjatë hartimit të projektit të instalimit të hidranteve në brendësi

dhe jashtë godinës. Ata janë instaluar në çdo kat në brendësi të godinës dhe janë lehtësisht të evidentueshme, praktikë, dhe për tu përdorur në rastet e shfaqjes së zjarrit.

Hidrantet DN 45 janë të përbërë prej saraçineskës ndërprerëse, tubit të gomuar për kalimim e ujit me një gjatësi prej 30 m si dhe hundëza. Të gjitha këto pajisje janë të vendosura në boksen prej llamarine çeliku, të lyer me bojë të kuqe RAL 3000 të pjekur, i cili vendoset në brendësi të murit ose jashtë tij (sipas zgjidhjes në projekt) dhe në një lartësi 110 cm nga dyshemeja sipas normave.

Ata janë të shoqëruar me kartelat e sinjalistikës përkatëse, me butonin e alarmit. Impianti i mbrojtjes kundra zjarrit gjithashtu me një valvol të posaçme siguron lidhje për autopompen e zjarrfikëses dhe për mjetet e shpëtimit. Kjo valvol shërben për lidhjen me mjetet e zjarrfikëses si për lidhjen e një hidranti të jashtëm ashtu edhe për furnizimin nga rezerva e autopompës. Kjo nënkupton një valvol prej tunxhi UNI 5035, një valvol moskthimi e përshtatshme për të evituar daljen jashtë të ujit nga impianti nën presion gjithashtu prej tunxhi, një valvol hidranti DN 70 prej tunxhi, një valvol sigurie e taruar në 1.2 MPa për shkarkimin e ujrave në ras mbipresioni. Të gjithë këto elementë janë të vendosur në boksen prej llamarine çeliku të lyer me bojë të kuqe RAL 3000 të pjekur, i cili vendoset në një lartësi 80 cm nga dyshemeja. Ajo është e shoqëruar me kartelat e sinjalistikës përkatëse.

Impianti hidrik furnizohet nga rrjeti kryesor i ujesjellesit që vjen nga linja kryesore e furnizimit të kesaj lagjeje të qytetit dhe me furnizim të mjaftueshem uji nga depozita e cila ka uje ne menyre te vazhdueshme edhe ne rast mungese uji nga rrjeti kryesor. Ujesjellesi eshte ndertuar me materiale te klases zero te reaksionit ndaj zjarrit si dhe i vendosur larg burimit qe mund te paraqese rrezit te zjarrit apo shperthimit, eshte i mbyllur me materiale te rezistencës ndaj zjarrit te klases O pa pengesa ne tere objektin dhe me zgjerim te njëjtë .

Fikset të lëvizshme të zjarrit - bombulat portative dhe karrelatot

Pajisjet e lëvizshme të shuarjes së zjarrit

- Bombola portative me gaz CO₂, pluhur për përdorim në zjarret e klasave A, B, E.

Fikëse me CO₂ përdoren për mbrojtjen në rast zjarri pikërisht për karakteristikat mbytëse të këtij gazi dhe variojnë nga 2 deri në 5 kg. Mbi flakën ky lloj shuarësi ushtron një efekt freskues dhe mbytës. Ky tip shuarësi përmbanë CO₂ në formë likuide dhe jo të gaztë të presurizuar. Në momentin e funksionimit një valvol lëshon CO₂ që ndodhet në fikës i cili arrin në një difuzor i cili e shpërndan në temperaturë -70 °C nën formën e një reje karbonike ose akulli të thatë. Cilësia kryesore e fikësve me CO₂ është se ky gaz nuk shkakton asnjë veprim korroziv dhe nuk lë pasojë pas përdorimit, nuk ndot dhe në përgjithësi ruan objektet nga dëmtimi. Këto bombula me gaz CO₂ janë aplikuar në ambientet e brendshme të godinës së spitalit, të pozicionuara sipas projektit.

Fikset me pluhur janë pajisje që përdoren në rast zjarri, të cilët zakonisht janë të adoptuar për të gjitha tipet e zjarrit - kjo shpjegon edhe arsyen se përse këto pajisje i gjejmë pothuajse në çdo ambient. Pluhuri është një material solid i ngjashëm me pudrën. Për ta bërë sa më funksionale kapacitetin e tyre fikës supozohet që mesatarisht një fikës prej 6 kg pluhur është në gjëndje që të shuajë rreth 200 litra substancë likuide të djegshme, e cila mund të jetë benzinë ose alkoool dhe është e aftë të fikë edhe zjarre me origjinë gazi. E meta e tyre e vetme që kufizon përdorimin e tyre është në efektet anësore të pas shuarjes së zjarrit. Përdorimi i fikësve me pluhur për të shuar zjarrin mbi një kompjuter apo kuadër elektrik apo cfarëdolloj aparature tjetër elektrike mund të shkaktojë dëme të pariparueshme të pajisjes elektrike. Këto bombula me pluhur janë aplikuar në ambientet teknike në kapacitete 6 kg, të pozicionuara sipas projektit.

Përdorimi praktik i fikëve të zjarrit :

Gjate përdorimit vepohet ne kete menyre:

-Fiksi merret me njerën dorë dhe pasi afrohet në distancë të afërt lihet në tokë . Me njerën dorë kapet siguresa ndërsa me të majtën mbahet bombula në pjesën e sipërme. Terhiqet fort siguresa hiqet dhe vihet në tokë me dorën e djathtë kapet dorëza shkarkuese në fund të tubit duke mbajtur në drejtim të vatrës së zjarrit. Njekohesisht dorë e majte shtyp poshtë fort valvulën e shkarkimit ndërsa me të djathtën shtypet dhe mblidhet dorëza duke realizuar hedhjen e mbushjes së pluhurit universal. Mbushja nuk hidhet mbi flakë por në vatrën e djegies. Këshillohet që pas hedhjes së mbushjes sidomos në mjedise të mbyllura të mos qendrohet afër dhe të përdoren mjete të thjeshtë mbrojtëse për frymëmarrjen si garze e lagur etj.

Mirembajtja dhe kontrolli

Vendosja e fikseve bëhet në pershtatje me objektin, në vende të dukshme me ajrosje pa lageshtirë që në cdo kohë mund të merret me lehtësi . Kontrolli teknik bëhet prej specialistit cdo vit e në rast nevojë rimbushen në qendrat e specializuara . Rimbushja bëhet pas cdo përdorimi..

Masat e parandalimit të përhapjes së zjarrit dhe tymrave

Kanalet e ventilimit dhe të kondicionimit, grilat dhe materiali i kanaleve të ajrit, tubat hidraulik, kanalinat elektrike të cilat përshkojnë muret horizontalisht nga njëri ambient në tjetrin, ose përshkojnë soletat apo dyshemetë vertikalisht nga njëri kat në tjetrin duhet të plotësojnë edhe kërkesat e mbrojtjes kundra zjarrit. Për këtë qëllim nëpërmjet masave të mos përhapjes së zjarrit dhe tymrave, kontrollin dhe evakuimit të këtyre të fundit, janë vendosur dampera kundra zjarrit, dampera tymi, qafore vetshuarëse, jastëk vetshuarës, stuko dhe materiale të tjera vetë shuarëse të cilat janë përcaktuar saktësisht në projektet e impianteve përkatëse.

Sinjalistika

Një element shumë i rëndësishëm është shoqërimi i të gjitha pajisjeve shuarëse, rrugëve të kalimit e të shpëtimit, me sinjalistikat përkatëse sipas normave me ndriçim normal dhe me ndriçim emergjence. Në projektin e mbrojtjes kundra zjarrit janë parashikuar një numër tabelash paralajmëruese, treguese dhe vepruese si :

- Tabela paralajmëruese - janë tabelat që tregojnë ndalimin e ndezjes së zjarreve, ndalimit të përdorimit të ujit për shuarje etj.
- Tabela treguese – sic janë drejtimet e daljes nëpër korridore, nëpër shkalle, vendosja e hidranteve dhe të bombolave etj.
- Tabelat vepruese–sinjalizimi nëpërmjet butonit të alarmit, ndërprerja e energjisë elektrike etj.

Projekti parashikon ndertimin e rrjetit të sinjalistikës për rastet e urgjencës. Por gjithashtu parashikohet që të vendoset edhe një panel qendror për të gjithë kornpleksin në ambientin e jashtëm dhe koridore. Linjat e rrjetit të sinjalizimit kalojnë në mure dhe nën shtresat e dyshemëve. Tubat plastik ku do të futen linjat e sinjalizimit duhet të jenë të forta dhe të panderprera nga butoni i sinjalizimit deri të paneli sinjalizues. Percjellesit janë me deje shumfish dhe izolim PVC. Edhe percjellesit që futen në to duhet të jenë të panderprera butoni i sinjalizimit deri paneli sinjalizues, Butonat e sinjalizimit vendosen 70cm mbi nivelin e dyshemëve. Duhet patur parasysh që butonet e sinjalizimit nuk duhet të vendosen në të njëjten kuti plastike me përdorues të tjerë. Ngjyra dhe forma e tyre do të përcaktohet në vend nga investitori.

Projekti parashikon ndertimin e rrjetit të sinjalizimit të zjarrit.

Rrjeti do të përbehet nga dedektoret të tymit dhe të nxehtësisë, të cilët janë tavanor dhe nga zilet e sinjalizimit të cilat do të vendosen në ambientet e koridoreve, holleve dhe ambienteve të jashtme. Zilja është e tipit audio – video (zhurme - drite). Linjat e rrjetit të sinjalizimit të zjarrit kalojnë në mure dhe mbi

tavan. Tubat plastik ku do të futen linjat e sinjalizimit të zjarrit duhet të jenë të forta dhe të pandërprera nga dedektori i sinjalizimit deri të zija e alarmit.

Skema e evakuimit

Ne rast rreziku shfaqjeje zjarri, evakuimi do bëhet në mënyrë vertikale e me pas horizontale në drejtimin perëndimor dhe verior. Hapesira e ndertimit ka shumë mundësi për një evakuim shumë të shpejtë pa sjelle rrezikshmeri në jetën e personelit dhe pacientëve. Brenda objektit, evakuimi sigurohet nga dera e jashtme në mënyrë natyrale e pozicionuar në perëndim por dhe në very të strukture, por edhe nga dritaret të cilat janë lehtësisht të hapshme me xham të thyeshëm dhe me pamje nga lindja dhe perëndimi . Objekti ka korridore të gjera që nuk sjellin vështirësi në lëvizje dhe nuk behen pengese për evakuim .

Ajrimi i të gjithë ambjentëve të brendshme do bëhet në mënyrë natyrale pasi ka hapesire të mjaftueshme . Duke ditur qëllimin kryesor të funksionimit të këtij objekti, në planvendosjen e kerkuar është vendosur që materialet , pjesë perberese të ndertimit të jenë materiale rezistente ndaj zjarrit . Llojet e zjarrit mund të shfaqen nga pakujdesia njëzore në përdorimin e materialeve që nuk lejohen , nga rrjeti elektrik si dhe nga shkarkimet atmosferike . Për parandalimin e zjarreve , që kanë të bëjnë me shpëtimin e njerëzve e të mirave materiale gjatë hartimit të këtij projekti , është konsideruar:

- Te minimizojnë shkaqet e zjarreve.
- Te garantojnë qëndrueshmërinë ndaj zjarrit të strukturave ndërtimore dhe të sigurojnë ndihmën ndaj të rrezikuarve.
- Te kufizojnë përhapjen e zjarrit në brendësi të objektit.
- Te mundësojnë largimin e të rrezikuarve nga ambienti ku ka rënë zjarr.
- Te kufizojnë përhapjen e zjarrit në objektet që janë pranë.
- Te garantojnë mundësinë për skuadrat zjarrfikëse dhe të shpëtimit, që të punojnë në kushte të sigurta,

Evakuimi : Në rast rreziku shfaqjeje zjarri evakuimi do bëhet në mënyrë horizontale-vertikale-horizontale në drejtimin perëndimor dhe në atë verior si dhe në drejtimin vertikal nëpërmjet shkalleve. Numri i personave mendohet rreth 70 (personel+paciente) . Zgjidhja funksionale dhe hapesira e ndertimit krijon mundësi për një evakuim shumë të shpejtë pa sjelle rrezikshmeri. Evakuimi horizontal është i mbrojtur pasi lëvizja midis ndarjeve drejt vendeve të sigurta kryhet me lehtësi dhe mjedise vështirësisht të djegshëm kjo në përputhje me rregullat për MZSH -ne.

Brenda objektit të kerkuar evakuimi sigurohet nga dyert e jashtme në katin përdehe në mënyrë natyrale . Dalja do të jetë e drejtperdrejt në katin përdehe pasi është në një nivel me sheshin e jashtëm që komunikon drejtperdrejt me këto strukture .

Në këto objekt do të përdoret sistemi i kombinuar për MZSH-ne duke përfshirë sistemin hidraulik i diktimit sinjalizim automatik , me fikse zjarri dore dhe të lëvizshme si dhe me mjete rrethore , fucia me rere , lopata , kazma etj të vendosura në objekt dhe të gatshme për përdorim në rast rreziku shfaqjeje zjarri.

Territori brenda objektit duket mbajtur i pastër , i rregullt dhe i sistemuar. Komunikimi ndërmjet ambjentëve është në mënyrë të drejtperdrejte.

Rruga kalimet dhe rrugët e komunikimit janë me gjerësi të mjaftueshme për lëvizje të lirë në rast shfaqjeje rreziku nga zjarri . Investitorit i është bërë i njohur që rrugët duhet të jenë të lira për kalim dhe me ndricim të mjaftueshëm natën .

Në territorin e objektit do të jenë të vendosura tabela orientuese që të disiplinojnë lëvizjen e automjeteve si dhe talela paralajmëruese të rrezikut ndaj zjarrit .

Investitorit i është bërë i njohur që të ndalohej brenda territorit prania e materialeve të ndryshme ndezese si barishte , kallamat , derrasa etj.

Per mbrojtjen nga zjarri krahas perdorimit te ujit do te kete dhe fikse zjarri dore si dhe fucia me rere per raste emergjente .

Ne kete objekt do kete uje te vazhdueshern i cili do te sigurohet nga rrjeti kryesor i fumizimit te kesaj zone dhe qe perdoret per nevoja emergjente te shuarjes se zjarrit apo per larjen e sheshit qe rrethon kete strukture. Pajisjet qe punojne nen tension do jene te izoluar ne menyre qe te kene kujdesin e duhur per ruajtjen nga shkarkimet e ndryshme elektrike qe rruund te ndodhin gjate procesit te shfrytezimit qe nga ushqimi me energji dhe ne kembet e punetorit dhe do jene te vendosura shtresa mbrojtese jopercjellese .

Energjia merret ne distance te afert nga rrjeti kryesor i tanishem dhe nga lidhja egzistuese dhe do shfrytezohet sipas kushteve teknike .

Relacion i Projektit Elektrik per MZSH-ne

1. Fumizimi me energji elektrike do behet ne lidhjen egzistuese.

2. Rrjeti elektrik i brendshern eshte projektuar per t'u realizuar ne perputhje me aktet ligjore dhe normat teknike per objektet e sherbimit . Rrjeti elektrik sipas projektit kalon totalisht ne tuba izolues vetsuare te cilet kane minimalisht 3-4 cm shtresa materialesh te padjekshme (suva f lluster etj.) dhe projektimi e ndertimi eshte bere ne menyre te tille qe impianti elektrik qe do ndertohet :

- nuk krijon premise per zjarr dhe shpërthim

- nuk krijojne burime ose rruge ushqimi qe favorizojnë shpërndarjen e zjarrit

-eshte llogaritur te jete vendosur e pajisur me aparatura te manovrueshme te vendosura ne pozicion "mbrojtjeje", ku duhet te vendosen qarte treguesit e qarqeve qe i përkasin..

Kuadri elektrik i përgjithshëm eshte vendosur ne pozicion te dukshem, lehtesisht te përdorshëm r sinjalizuar me tregues dhe i mbrojtur nga zjarri.

Sistemi i brendshem eshte i ndertuar me percjellese shumefijesh dhe te standarteve te larta I mbrojtur me automate dhe me salvavida .

3. Rrjeti elektrik i jashtem eshte i realizuar i futur ne toke me percjellese shumefijesh te standarteve te fundit te miratuara, i futur ne tuba fleksibel te rende f te padjegshem. Rrjeti eshte i mbrojtur me mbrojtëse automate dhe salvavite dhe sherben per furnizimin e sistemit te pompave te karburanteve , ndricimin e jashtem te te gjithë objektit, ndricimin e tabelës se reklamave dhe per perdorime te tjera te nevojshme .

Sistemi i tokezimit eshte realizuar i plote dhe ne menyre te harmonizuar dhe te lidhur midisobjekteve te vecanta. Projekti parashikon qe godina te furnizohet me linje te veçante direkt nga kabina elektrike. Per te eleminuar demtimet fizike dhe çdo kontakt fizik linja do te mbulohet perseri me kaneline metalike dhe do te filsohet me bulona. Kaseta kryesore elektrike do te vendoset ne ambientet e katit perdhe. Nga kaseta kryesore elektrike do te behet furnizimi i kasetave te brendshme. Te gjitha kasetatelektrike te me siperme do te vendosen ne ambientet e koridoreve te sherbimit. Te gjithë kasetat elektrike do te jene me konstruksion metalik dhe me kapak me çeles

Rrjeti i kanalizimit .

Rrjetet jane me tuba plastik te forte dhe kalimi i lijnave do te jete kryesisht nen nivelin e dyshemese dhe ne mure. Te gjithë linjat do te mbulohen me kartonxhes, gjithashu per te eleminuar xhurmat do te vishen me shtresa qilimi me pambuk mineral. Shkarkimet do te behen ne pusetat qe do te ndertohen perreth objektit. Keto puseta jane prej betonarmeje dhe me permasa 80 x 80 x 100 - 200cm. Pika e lidhjes me rrjetin ekzistues do te percaktohet ne vend nga investitori dhe ndermarja perkatese qe e ka nen administrim territorin. Ne piken e lidhjes do te ndertohet nje puset e re. Tubat e shkarkimit te kanalizimit te jashtem jane plastik dhe me siperfaqe te viaskuar nga jashte dhe te lemuar nga brenda. Tubat duhet te jene pa nderprerje nga puseta ne puset. Lidhja apo zgjatimi I tyre do te behet ne perputhje me teknologjine e kerkuar nga prodhuesi i tyre. Ne projekt eshte parashikuar gjithashtu ndertimi i sistemit te mbrojtjes kunder zjarrit. Per kete parashikohet

vendosja e depozitave 4x 4000lt ne pjesen perendimore te zones. Ne dalje do te vendoset nje grup me tre pompa uji me vakum dhe prej ketu do te furnizohen te gjithe hidrantet e parashikuara ne projekt.

Mbrojtja nga ngarkesat elektrostатike

Gjithashtu duke patur parasysh dhe mundesine e pashmageshme te lindjes se rrymave elektrostатike gjate levizjes se lengut (produktit te naftes) neper tubacione, rezervuare etj, gjate proceseve te ngarkimit e shkarkimit, dukuri kjo e rrezikshme per lindjen e vatrave te zjarrit, ne projekt jane marre masa per evitimin e pasojave. Mbrojtja nga rrymat elektrostатike te tubacioneve te linjave teknologjike te projektuara, realizohet permes lidhjeve te konstruksioneve metalike te tyre , tek pajisjet e sistemit te tokezimit. Rezistenca e kalimit te rrymes jo me shume se 100 ohm.

Mbrojtja nga shkarkimet atmosferike

Ne kuadrin e mbrojtjes se objektit nga mundesia e lindjes se zjarrit eshte parashikuar edhe mbrojtja e tij nga shkarkimet atmosferike. Ne projekt jepet qarte skema e rrjetit te mbrojtjes se struktures nga shkarkimet atmosferike.

- Sistemi i mbrojtjes nga shkarkimet atmosferike të realizohet sipas skemës së më poshtëme
- Rrjeta e rrufepritësit përmbi shtresat të realizohet me kuadrate të vendosur mbi kubikë plastik të tipit 7000/S.
- Kubikët të jenë të paisur me morseta të tipit 5113.
- Rrjeta e rrufepritësit të realizohet me shirit zingato me seksion \varnothing 8mm².
- E gjithë mbulesa e struktures të konturohet me shirit zingato \varnothing 8mm², i cili fiksohet në parapetin e mbuleses me anë të morsetave tip 5113 dhe që lidhen me rrjetin e rrufepritësit.
- Permasat e vendosjes se morsetave eshte orientuese.
- Percaktimi i sakte do te behet ne vend.
- Distanca e morsetave nga njera tjetra është 0.80 ÷ 1.2ml.
- Lidhja e konturit me rrjetin bëhet me anë të morsetave 5113.
- Pritësat të realizohen me shufër zingato \varnothing 10mm² dhe me gjatësi 1ml.
- Pritësit të vendosen në pikat '1t' ÷ '43t'.
- Kapja e pritësit me konturin të realizohet me morset të tipit 5113.
- Zbritësat të realizohen me shufra zingato me seksion \varnothing 10mm², i fiksuar me morsetën tip 5113 mbi sipërfaqen e suvasë së jashtme.
- Zbritjet të realizohen ne pikat '1z'; '2z'; '3z';'4z' .
- Zbritjet të lidhen me rjetin ekzistues të elektrodave të tokëzimit deri në ndërtimin e rrjetit të ri.
- Gjatesia e elektrodave është 150cm.
- Rezistenca e tokëzimit e matur në kohë të thatë të ketë vlerat $R_t \leq 4.8\Omega$

Programi i Monitorimit te Mbrojtjes nga Zjari dhe Shpetimi

Monitorimi i mbrojtjes nga zjarri dhe shpetimi - Personi juridik qe po merret me zhvillimin e ketij objekti dhe gjate shfrytezimit te tij eshte i detyruar te zbatoje ligjin "Per emergjencat civile ":

- a) te hartojnë plane per situatat e emergjences civile dhe te zbatojnë masat parandaluese ne kete strukture
- b) te njoftojnë personelin si dhe autoritetet perkatese per një rrezik imediat .
- c) te organizojnë, kur është e nevojshrne, evakuimin e personelit dhe pacienteve, dhe te vene ne veprim shërbimin e tyre "ne përgjigje te një situate emergjence ne kete strukture .
- ç) te sigurojnë trajnimin per personelin.

Eshte parashikuar nje izolim shume i mire i mbuleses se kesaj siperfaqeje ndertimi dhe i mureve anesore ne menyre qe te mos ndikojne ne perkeqesimin e fenomeneve te ngrohjes dhe ftohjes atmosferike ne menyre qe te coje ne nje ambient te pershtatshem pa konsumuar shume energji te nevojshme per ngrohje - ftohje dhe duke siguruar ne kete menyre nje perdorim racional te tyre.

Ambjentet e kesaj strukture jane te pajisura me pajisje bashkekohore te nevojshme per realizimin e ketij aktiviteti si dhe te sherbimeve qe jane menduar me pare. Pajisjet qe po perdoren per realizimin e proceseve te ndryshme jane te reja , te izoluara ne menyre qe te kene kujdesin e duhur per ruajtjen nga shkarkimet e ndryshme elektrike qe mund te ndodhin gjate procesit te shfrytezimit qe nga ushqirni me energji .

Pajisjet e ndihmës se shpejtë duhet te jenë te disponueshme gjithashtu ne te gjitha vendet ku e kërkojnë kushtet . Ato duhet te kene një sinjalistike te përshtatshme dhe te jenë te arritshme lehtësisht.

Nje sinjalistike lehtësisht e dukshme duhet te tregojte adresën dhe numrin e telefonit te shërbimit lokal te urgjencës.

Monitorimi i mbrojtjes nga zjarri :

Personi juridik ne zbatim te Nenit 38 te Ligjit Nr.152/2015 "Per sherbimin e mbrojtjes nga zjari dhe shpetimin detyrohet : .

a) zbatojnë dispozitat e parashikuara nga ky ligj dhe aktet e tjera nenligjore per sigurinë nga zjarri dhe shpëtimin:

b) Te marre masa per parandalimin e pakësimit e zjarreve, me anë te mjeteve, sistemeve, pajisjeve te diktimit-sinjalizimit per shuarjen e zjarreve.

c) Te kontrollojë, te paktën një herë ne vit, gjendjen e masave, mjeteve dhe pajisjeve per sigurinë ngazjarri dhe shpëtimin,

ç) Te planifikojnë fonde financiare per ndërtimin dhe përmirësimin e infrastrukturës per sigurinë nga zjarri dhe shpëtimin:

d) Te planifikojnë fonde financiare per ngritjen e grupeve ziarrfikëse dhe trajnimin periodik te tyre si dhe t'i mbajnë ato ne gatishmëri:

e) hartojnë rregullat e brendshrne per sigurinë nga zjarri dhe shpëtimin, ne përputhje me rrezikshmërinë e tyre.

Personi juridik ne zbatim te sa me siper dhe VKM-se Nr.699 , dt.22.10.2004 persa i perket parandalimit te zjarrit te instalimeve elektrike :

- nuk duhet te krijojnë premisë per zjarr dhe shpërthim:

- nuk duhet te krijojnë burime ose rruge ushqimi, qe favorizojnë shpërndarjen e zjarrit

- te jene vendosur e pajisur me aparatura te manovrueshme te vendosura ne pozicion "mbrojtjeje", ku duhet te vendosen qarte treguesit e qarqeve qe i përkasin (këto te fundit te shënuara).

Vlerësimi i rrezikut te zjarrit mundëson identifikimin e niveleve te rrezikut që paraqet çdo mjedis.Ky nivel përcakton probabilitetin e zjarrit dhe pasojat e dëmshme per personat dhe pajisjet e pranishrne. Përcaktimi i nivelit te rrezikut te zjarrit ben te mundur identifikimin e masave që duhen marre për te reduktuar shkaqet dhe përhapjen e zjarrit.

Vlerësimi i rreziqeve njih faza te ndryshme nëpërmjet te cilave identifikohet strategjia me efikase kundër zjarrit ne ambientin e ekzaminuar. Pronari i pasurise , pasi te ketë kryer vlerësimin e rrezikut te zjarrit dhe pasi te ketë identifikuar situatat qe paraqesin rrezik duhet te marre masat e sigurise, ne mënyrë që te kompensojë rreziqet e mundshme.

Një nga elementët bazë që duhet patur parasysh ne kete proçes vlerësimi është se rreziku nuk mund te jete kurrë i barabartë me zero. Ekziston gjithmonë një përqindje rreziku e cila duhet mbajtur ne nivel te tillë që te konsiderohet e pranueshrne. Reduktimi i rrezikut te zjarrit mund te arrihet permes miratimit te masave

parandaluese që kanë për qëllim reduktimin e probabilitetit të shfaqjes së zjarreve dhe të masave mbrojtëse që kanë për qëllim reduktimin e efekteve të zjarrit. Reduktimi I probabilitetit të shfaqjes së një zjarri mund të bëhet me aplikimin e masave me natyrë teknike, si psh:

- të realizohen impiante në përputhje me normat;
- impiantet, strukturat dhe masat metalike të realizohen nën tokë, në mënyrë që të shmanget formimi i ngarkesave elektrostatike;
- krijimi në bazë të normave të sistemeve të mbrojtjes kundër shkarkesave atmosferike
- të ajrosen menjëherë ambientet në prani të avujve, gazrave, ose pluhurave të djegshëm
- të përdoren mjete sigurie që parandalojnë zjarrin ose shpërthimin:
- të meren masa të tipit organizativ / menaxhues:
- të respektohet rregulli dhe pastërtia:
- përgatitja e një rregulloreje të brendshme, mbi kontrollin e masave të sigurisë që duhen respektuar.

Për përballimin e emergjencave :

Personi juridik që po merret me zhvillimin e kësaj strukture dhe gjatë shfrytëzimit të tij është i detyruar të zbatohet ligji "Për emergjencat civile "

- a) të hartojnë plane për situatat e emergjencës dhe të zbatojnë masat parandaluese në këto zone
- b) të njoftojnë personat si dhe autoritetet vendore për një rrezik imediat ;
- c) të organizojnë, kur është e nevojshme, evakuimin e personave dhe të vënë në veprim shërbimin e tyre në përgjigje të një situatë emergjence në zonën e objektit.

ç) të sigurojë trajnimin për personelin dhe jo vetëm për të mbrojtur shëndetin dhe sigurinë e njerezve nga pasojat e aksidenteve ose të emergjencave të caktuara të shkaktuara, të vendosi procedurë të pershtatshme nderhyrje për tu zbatuar në këto raste. Këto masa përfshijnë ushtrime praktike për sigurinë që duhet të kryhen me intervale të rregullta dhe vënie në dispozicion të mjeteve të pershtatshme për ndihmën e shpejtë. Personave të autorizuar duhet të jepen veshje mbrojtëse, mjete të mbrojtjes individuale dhe mjete të pershtatshme për nderhyrjen që përdoren deri sa vazhdon situata anormale. Pronari i objektit:

- a) merr masa paraprake për të organizuar dhënien e ndihmës së parë, mbrojtjen nga zjarri dhe evakuimin në rastet kur ka rrezik për të ndodhur ngjarje;
- b) merr masa për të ulur, sa më shumë të jetë e mundur, kërcënimet për sigurinë dhe shëndetin e personave të pranishëm:
- c) organizon dhe siguron evakuimin e shpëtimit të personave në rast ngjarjesh ose aksidentesh të papritura, që kërcënojnë sigurinë dhe shëndetin e tyre;
- ç) trajnon personat, që do të kryejnë evakuimin e shpëtimit dhe siguron, me anë të personave të trajnuar, realizimin e evakuimit të shpëtimit, fikjen e zjarrit dhe dhënien e ndihmës së shpejtë me pajisjet e nevojshme:

d) harton një plan për evakuimin dhe shpëtimit në situata emergjente, të cilin ia bën të ditur të gjithë personave që jetojnë apo përdorin ambientet e objektit, si dhe kryen ushtrime praktike, të paktën një herë në dy vjet, në përputhje me këtë plan,

dh) organizon dhe jep ndihmën e shpejtë për personat e dëmtuar që pësojnë sëmundje të papritura, derisa ata të dërgohen në një institucion të kujdesit shëndetësor:

e) cakton të paktën një person të trajnuar, i cili mund të japë ndihmën e shpejtë, të fikë zjarrin ose të kryejë veprime shpëtimi a evakuimi.

Në rast zjarri merren këto masa:

- Lajmerohen zjarrfikësit ose komunikohet në numrin e telefonit perkates
- Vihen në përdorim fikset e zjarrit
- Fiket celsi kryesor i energjisë,

- Ndalohen te nderhyjne ne rrjetin elektrik personat qe skane autorizim
-Kerkohet ndihme e shpejte nepermjet numrave te tel te emergjences :

- 128 PMNZSH
- 129 Policia e Shtetit
- 127 Sherbimi Shendetesor

-Kontrollohen ambjentet duke mos perdorur ndricim me flake te hapur .

-Mos u largo nga objekti pa u siguruar qe nuk ka rrezik zjarri

-Verifikohen ne menyre te vazhdueshme mjetet e fiksjes se zjarrit.

Te gjitha personat qe banojne dhe shfrytëzojne objektin duhet te jene te informuar ne lidhje me:

- masat e parandalimit dhe mbrojtjes nga zjarri dhe ne veçanti:

- vendndodhja e mjeteve kundër zjarrit;

- vendndodhja e rrugëve te daljes;

- menyra e hapjes se dyerve te daljes:

- sjellje korrekte ne rast zjarri, si per shembull: te mbahen te mbyllura dyert rezistente ndaj zjarrit;

- veprimet që duhen ndërmarrë kur zbulohet një zjarr;- si te përdorim alarmin;

- veprimet që duhen ndërmarrë kur dëgjohet alarmi;

- procedurat e evakuimit dhe grumbullimit ne nje vend te sigurt;

- menytrat se si te lajmërohen zjarrfikësit.

Per te gjitha materialet qe do te perdoren do te paraqitet certificate cilesie sipas standarteve te Bashkimit European.

“ ARABEL STUDIO “ SHPK
ADMINISTRATORI

Zj. ANA NISHKU

“NET GROUP “ SHPK
ADMINISTRATORI

Z. VALTER BEGAJ